

**GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,  
SEZONI 2022/2023  
(java e 43-të, deri më 30.10.2022)**

Gjatë javë së 43-të të vitit 2022 (nga 24-30.10.2022), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar gjithsej 15 raste ( $I=0,82/100000$  banorë) raste të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që përkon me këtë periudhë të sezonit dhe me mesataren e sezoneve të kaluar.

Personat e sëmurë janë nga Tetova – 7, Gostivari – 6, Strumica- 1 dhe Prilepi – 1.

Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 vjet janë regjistruar 13 persona dhe nga 5 deri në 14 -2 persona.

Nga java 40-42 gjithsej janë regjistruar 62 raste ( $I=3,4/100.000$ ).

Gjatë javës së 43-të, pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 251 materiale për analiza laboratorike për gripin, nga të cilat 4 nga mbikëqyrja SARI, paralelisht të analizuara edhe për grip edhe për COVID-19 dhe të gjitha kanë rezultuar negative për prani të virusit të gripit.

Deri më tani janë testuar gjithsej 1.052 materiale dhe 1 rast ka rezultuar pozitiv për prani të virusit të gripit - Influenza A(H3).

### **Vaksinimi kundër gripit**

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2021/2022, Ministria e shëndetësisë siguroi 40 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës.

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2022/2023 filloi në 19.10.2021 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes [www.vaksinacija.mk](http://www.vaksinacija.mk).

6.000 vakcina shtesë jani siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një komepsim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për shëndetësi elektronike, që nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti gjithsej janë vaksinuar 31.516 persona të grupeve të rrezikuara të popullatës me vakcina falas. Sa i përket vaksinave komerciale 1.275 persona.

**Deri në javën e 42 në RMV janë vaksinuar gjithsej 17.533 persona me vakcina komerciale.**

*Tabela 1. Shpërndarja e të vaksinuarve kundër gripit sezonal, sipas QSHP/NJR, sezoni 2022/2023*

<i>QSHP/NJR</i>	<b>Numri i të vaksinuarve kundër gripit sezonal</b>
<b>MANASTIR</b>	<b>2101</b>
Demir Hisar	97
Kërçovë	708
Prespë	434
<b>VELES</b>	<b>1152</b>
Gjevgjeli	985
Kavadar	1119
Negotinë	787
Sv. Nikole	470
<b>KOÇAN</b>	<b>1264</b>
Berovë	294
Vinicë	541
Dellçevë	317
Pehçevë	168
<b>KUMANOVË</b>	<b>1273</b>
K. Pallankë	555
Kratovë	243
<b>OHËR</b>	<b>1528</b>
Dibër	323
Strugë	968
<b>PRILEP</b>	<b>1233</b>
Krushevë	118
M. Brod	164
<b>SHKUP</b>	<b>9634</b>
<b>STRUMICË</b>	<b>1628</b>
Vallandovë	176
<b>TETOVË</b>	<b>1334</b>
Gostivar	1194
<b>SHTIP</b>	<b>1180</b>
Probishtip	261
Radovish	542
<b>MAQEDONIA E VERIUT</b>	<b>32.791</b>

Sipas raportit të Flu News Europe të publikuar për javën e 42-të vitit 2022, për aktivitetin e virusit të gripit në mbarë rajonin Evropian.

- Dy vende nga rajoni (Skocia) ka raportuar përhapje të gjerë të aktivitet të virusit të gripit.
- Gjermania, Kazakistani, Portugalia dhe Spanja kanë raportuar për një nivel të aktivitetit të virusit të gripit mbi 10% në mbrojtjen shëndetësore primare sentinel.
- Nga 339 raste SARI të testuara për grip, 64 kanë qenë pozitive, nga të cilat 59(92%) kanë qenë influanca B.
- Janë detektuar edhe Influenza A edhe Influenza B, me një dominancë të A(H3).
- Janë raportuar hospitalizime të rasteve të konfirmuara në laborator nga repartet e kujdesit intensiv dhe rasteve nga SARI.

Sipas treguesve kualitativ në raport me intenzitetin, 31 vende janë në nivel bazik, ndërsa 8 me intenzitet të ulët. 1 me intenzitete mesatar dhe 1 me intenzitet të lartë. Sipas shpërndarjes gjeografike, 17 vende nuk kanë regjistruar aktivitet të virusit të gripit, 17 kanë raportuar raste sporadike, 1 vend shpërndarje rajonale ndërsa 2 vende shpërndarje lokale.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive  
Instituti i Shëndetit Publik